



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJË
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

B.Curri më 18.01.2018

SHPLLJE

PËR LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NE DETYRË DHE PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË E ULËT E DREJTUESE NE POZICIONIN E PUNËS

Përgjegjës i Sektorit Zhvillimit Rural

Niveli minimal i Diplomës Master Shkencor ose i barazvlefshëm diplomuar , në Shkenca bujqësore agronomi, veterinar, zotënikë ose inxhinjeri mjedisi.

Kategoria e III-a/1

Në zbatim të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Kreut I, II, III, IV. VKM.nr.242, datë 18/03/2015, Bashkia Tropojë , shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë e ulët e të mesme drejtuese për pozicionin:

Përgjegjës i Sektorit Zhvillimit rural , vende të lira pune 1 (një), në Drejtorinë e PZHT, në Bashkinë Tropojë – Kategoria III-a/1.

Pozicioni më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele.

Vetëm në rast se këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë vakante, atëherë janë të vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së Ngritjes në detyrë ose pranimit në shërbimin civil për kategorinë e ulët drejtuese .

Për të dy procedurat lëvizje paralele dhe ngritjes në detyrë në kategorinë e ulët drejtuese aplikohet në të njëjtën kohë .

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentave për **LEVIZJE PARALELE: 29.01.2018**

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentave për **PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: 02.02.2018**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:

Siguron drejtimin e sektorit zhvillimit rural për përgatitjen dhe përditësimin të planeve dhe objektivave, me qëllim arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të kësaj strukture; -Është përgjegjës për drejtimin dhe kontrollin e realizimit të detyrave nga punonjësit e sektorit që

drejton;

Bashkërendon bashkëpunimin midis njësisve të tjera përbërëse të drejtorisë dhe me njësitë e tjera organizative;

-Jep detaje, në përputhje me fushën përkatëse të kompetencës, për materialet që paraqiten në Këshillin Bashkiak, si dhe ndjek dhe kujdeset për zbatimin e vendimeve të marra.

-Ofron mbështetje dhe këshilla për eprorët, në interpretimin dhe zbatimin e strategjive, politikave, planeve të sektorit zhvillimit rural.

-Realizon ndarjen e punës, jep instruksione dhe ndihmën e domosdoshme për punonjësit direkt për përmbushjen e detyrave;

-Siguron marrëdhënie të rregullta komunikimi me vartësit që drejton, duke garantuar vazhdimësinë e punës nëpërmjet transparencës në transmetimin e urdhërave dhe caktimin e përgjegjësisve;

-Kordinon veprimtarinë e punës Sektorit në funksion të zgjidhjes së problemeve të ndryshme;

-Siguron zbatimin e programit të detyrave për punonjësit duke klasifikuar prioritetet përkatëse;

-Vlerëson, aftësitë dhe performancën e përgjithshme të punonjësve në vartësi, duke përgatitur vlerësimet me shkrim të rezultateve në punë;

-Udhëzon vartësin për përmbushjen e aktivitetit të përditshëm dhe siguron që kjo veprimtari të jetë në përputhje me legjislacionin, politikat institucionale dhe standardet përkatëse.

-Në mënyrë të planifikuar realizon pritjen e qytetarëve, merr kërkesat e tyre dhe jep përgjigjet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

-Përgatit në kohë dhe me cilësi materiale informuese për eprorët, me qëllim arritjen e objektivave dhe përmbushjen e detyrave të Drejtoris PZHT;

-Identifikon nevojat për përmirësim dhe bën rekomandime brenda funksioneve dhe kompetencave të sektorit.

-Përgatit raporte periodike dhe informon eprorët për ecurinë e punës në sektorin e zhvillimit rural.

-Zbaton rekomandimet apo sugjerimet e eprorëve me qëllim përmirësimin e praktikave apo procedurave të zbatuara

-Mban regjistrin e bonitetit dhe pronësis së tokës bujqësore.

-Harton, sistemon, e mirmban te gjith dokumentacionin hartografik te bashkise

-Përgatit dokumentacionin për paisjen e fermerve me AMTP, dhe e miraton në organet vendimmarrëse.

-Jep konsulencë të vazhdueshme fermerve në fushen e bujqësisë.

-Mban marrëdhënie me tretët sipas kërkesave të eprorëve.

-Mban lidhje me homologët apo zyrtarë të tjerë të qeverisjes qendrore apo asaj vendore sipas kërkesave të eprorëve .

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori (III-a/1), në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

- **Kriteret e përgjithshme dhe të posaçme**
- Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori.
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mire”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojnë diplomë te nivelit Master shkencor ose të barasvlefshëm në (Shkenca Bujqesore (agronomi ,veterinari,zoteknikose inxhinjeri mjedisi.edhe diploma e bachelorit duhet të jetë e së njëjtës fushë..
- Të ketë eksperiencë pune të paktën 5 vjet vjetërsi pune në profesion.

• DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dorazi ose nepermes postes pranë sekretari-arkivit të Bashkisë Tropojë, dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://administrata.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- Fotokopjet e diplomës masterit Shkencor ose te barasvlefshme (përfshirë edhe diplomën bachelor) dhe listën e notave.Nëse studimet janë kryer jashtë vendit duhet te sillen njësimi i diplomës nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë).
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID).
- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore.
- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore.
- Vlerësimin e fundit nga eprori direKt.
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ke masë disiplinore ne fuqi.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të BashkisëTropojëbrenda datës **29.01.2018**

.REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **31.01.2018**. Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Tropojë do të shpallë në Stendën e Informacionit të Institucionit të Bashkisë dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën paraprake të kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit , për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail),ndërsa lista e verifikuar e kandidateve do të shpallet me dt.**08.02.2018**. Po në këtë date kandidatët do të njoftohen për datën,vendin dhe orën e saktë se ku do të zhvillohet intervista me gojë.

.FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET KONKURIMI.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- 1-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
- 2-Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”i ndryshuar .
- 3-Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”,
- 4-Kodi i Procedurave Administrative.

5-Ligji nr.7501 dt.19.07.1991 “Për token bujqesore” i ndryshuar
6-VKM nr 230 dt.23.7.1991 “Për krijimin e komisionit ndarjes tokes” i ndryshuar
7-Vkm nr. 255 dt. 02.08.1991 “Për kriteret e ndarjes tokes bujqesore “Indryshuar
8-VKM nr 253 dt.6.03.2013 “Për përcaktimin e procedurës të plotesimit të AMTP
9-VKM nr 994 dt.09.12.2015 “Për procedurat e Regjistrimit të akteve të marrjes tokës në pronësi.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar,kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës.
- Eksperiencën e tyre të mëparshme.
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al” <http://administrata.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT.

Në përfundim të testit me shkrim dhe intervistes strukturuar me gojë të kandidatëve,njoftimi ipër fituesin do të shpallet në Stendën e Informacionit të Bashkisë Tropojë dhe në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

2.-NGRITJA NË DETYRE NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë në shërbimin civil për kategorinë e ulet drejtuse.Këtë informacion do ta merrni në Portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe në Stendën e Informacionit të Bashkisë Tropojë , pas përfundimit të konkurimit të kandidateve në lëvizjen paralele,informacion te cilin do ta merrni nga dt..**08.02.2018** e në vazhdim

2.1- KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

- a - Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë IV-a
- b - Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c - Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë te nivelit Master Shkencor ose të barazvlefshëm në Shkencat Bujqesore (agronomi, veterinar, zotënik ose inxhinjeri mjedisi) edhe diploma e Bachelorit duhet të jetë e së njëjtes fushë.
- Të ketë eksperiencë pune të paktën 5 vjet në profesion

2.2-DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://administrata.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor) nëse studimet janë kryer jashtë shtetit duhet të përcillet edhe njësimi i diplomes nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë).
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID).
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore.
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- Kopje të Vlersimit fundit nga eprori direkt
- Vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi nga institucioni ku punon..
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhen pranë Njësisë së Burimeve Njerëzore, Bashkia Tropojë ose nëpërmjet shërbimit postar.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës 02.02.2018

2.3-REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **12.02.2012** Bashkia Tropojë do të shpallë në Stendën e Inforacionit të Bashkisë Tropojë dhe në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën paraprake të kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e ngritjes në detyrë ose pranimit në kategorinë e ulët drejtuese.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet për kualifikim dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Bashkia Tropojë, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ndërsa me dt. **22.02.2018** do të shpallet lista e verifikuar e kandidateve konkurrense që vazhdojnë konkurimin si dhe vendin, datën dhe orën e zhvillimit të testimit me shkrim dhe intervistën e strukturuar me gojë.

2.4-FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- 1-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
- 2-Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”i ndryshuar .
- 3-Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.
- 4-Kodin e Proçedurave Administrative.
- 5-Kodin e etikës.
- 6-Ligji nr.7501 dt.19.07.1991 “Për token bujqesore” i ndryshuar
- 7-VKM nr 230 dt.23.7.1991 “Për krijimin e komisinit ndarjes tokes“ ndryshuar
- 8-Vkm nr. 255 dt. 02.08.1991 “Për kriteret e ndarjes tokes bujqesore” i ndryshuar
- 9-VKM nr 253 dt.6.03.2013 “Për përcaktimin e proçedures të plotësimit të AMTP.
- 10-VKM nr.994 dt.09.12.2015 “Për proçedurat e Regjistrimit të akteve të marrjes tokës në pronesi

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet.
- Eksperiencën e tyre të mëparshme.
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 -MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.
- Testimi me shkrim, deri në 40 pikë;
- Intervistën e strukturuar me gojë qe konsiston ne motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al” <http://administrata.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>.

2.6- DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

.-Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në “portalin e shërbimit kombëtar të punësimit” .
Për fazat e mëtejshme të proçedurës së pranimit në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive: për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak, datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

-Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë proçedurë të cilët nuk kualifikohen do të njoftohen

individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

-Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme Portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit” dhe Stendën e Informacionit të Publikut të Bashkisë Tropojë duke filluar nga data **12.02.2018** e në vazhdim.

- Në përfundim të konkurimit Bashkia Tropojë do të shpallë fituesin në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe Stendën e Informacionit të Publikut të Bashkisë.

SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE